

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18) dhe duke vepruar në bazë të njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga Certis Belhim B.V. me seli të regjistruar në Shtadsplatau 16, Posta 607, 3500 AP Utreht, Holandë, dhe Redestos S.A. me seli të regjistruar në Zonën Industriale të Selanikut, Posta 48, 570 22 Sindos, Greqi, nëpërmjet avokatit Bozhidar Millosheviq nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 13.09.2024, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Certis Belhim B.V. me seli të regjistruar në Shtadsplatau 16, Posta 607, 3500 AP Utreht, Holandë, dhe Redestos S.A. me seli të regjistruar në Zonën Industriale të Selanikut, Posta 48, 570 22 Sindos, Greqi, formojnë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës më 29.07.2024, e plotësuar më 26.08.2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), është dorëzuar njoftim i përqendrimit nga Certis Belhim B.V. me seli të regjistruar në Shtadsplatau 16, Posta 607, 3500 AP Utreht, Holandë, dhe Redestos S.A. me seli të

regjistruar në Zonën Industriale të Selanikut, Posta 48, 570 22 Sindos, Greqi, me të cilin Certis Belhim B.V. formojnë një sipërmarrje të përbashkët me funksione të plota.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Certis Belhim B.V. është nën kontrollin përfundimtar të Mitsui & Co., Ltd. (Mitsui & Co., Ltd.; së bashku me shoqëritë e saj të varura - "**Matsui Group**")

Grupi Mitsui është një nga konglomeratet më të mëdha të korporatave (i ashtuquajturi *keiretsu*) në Japoni. Grupi Mitsui përfshin një sërë shoqëri, shumica e të cilave janë korporata të mëdha ndërkombëtare si Mitsui & Co. (Mitsui & Co.); Mitsui Chemicals (Mitsui Chemicals); Mitsui Konstrakshn Ko. (Mitsui Construction Co.); Mitsui Enzhinering and Shipbuilding Ko. (Mitsui Engineering and Shipbuilding Co.), Mitsui Majning & Smelting Ko. (Mitsui Mining & Smelting Co.), etj.

Mitsui & Co. (Mitsui & Co.) është shoqëria kryesore në Grupin Mitsui dhe një nga shoqëritë më të mëdha tregtare të përgjithshme në Japoni

Shoqëria kryesisht funksionon si një shoqëri holding e disa shoqërive të varura dhe të lidhura, e cila menaxhon porositë dhe organizon dërgimin e mallrave dhe mallrave industriale, bujqësore dhe të konsumit.

Në përgjithësi, Grupi Mitsui ka shtatë segmentet e mëposhtme të funksionimit: Burimet minerale dhe metalike, Energjia, Inxhinieria dhe Infrastruktura, Kimikatet, Produktet e Hekurit dhe Çelikut, Mënyra e jetesës dhe Inovacioni dhe Zhvillimi i Korporatës.

Certis Belchim B.V është një shoqëri globale me qendër në Utreht, Holandë, nën kontrollin e pavarur të Grupit Mitsui. Certis Belchim B.V është aktive në sektorin e mbrojtjes së bimëve me fokus në bujqësinë e qëndrueshme, mbrojtjen e bimëve, zhvillimin e produkteve, regjistrimin dhe marketingun brenda industrisë bujqësore. Shoqëria ka një prani të drejtpërdrejtë, nëpërmjet shoqërive të varura të saj, pothuajse në të gjitha vendet në Evropë, Shtetet e Bashkuara dhe Kanada dhe bën shitje përmes partnerëve të saj lokalë në Azi, Amerikën e Jugut, Afrikë dhe Australi.

Në Maqedoninë e Veriut, Certis Belchim B.V. shet produkte për mbrojtjen e bimëve përmes distributorëve vendas - palëve të treta ose përmes shitjeve të drejtpërdrejta të eksportit, dhe kështu ka realizuar të ardhura në vitin që përfundon më 31 mars 2023.

Për sa i përket pranisë së regjistruar në Maqedoninë e Veriut, Certis Belchim BV është i pranishëm vetëm në KNE Certis BV dhe shoqërinë e saj të varur në pronësi të plotë KNE CERTIS SHPKNJP Gevgelija, me seli të regjistruar në bulevardin e Gjevgjelisë nr. 16, Gjevgjeli.

Grupi Redestos është aktiv në sektorin e bujqësisë në Greqi, Evropën Juglindore dhe Lindjen e Mesme. Aktivitetet e Grupit Redestos përfshijnë njësitë e mëposhtme të biznesit: mbrojtjen

dhe kultivimin e bimëve, materialet e shumimit të bimëve, shërbimet laboratorike dhe konsulente dhe prodhimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore.

Redestos është aktiv në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave.

Në Maqedoninë e Veriut, Redestos Group është i pranishëm përmes KNE Certis BV dhe shoqërisë së saj të varur në pronësi të plotë, KNE CERTIS SHPKNJP Gevgelija, e cila është aktive në tregtinë me shumicë të produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave

Ndërmarrja e përbashkët do të specializohet në shitjen e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave në Ballkan dhe rajonet përreth. Përveç shitjeve, KNE do të angazhohet edhe në prodhimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, plehrave të specializuara dhe farërave

Transaksioni i propozuar do të përbëhet nga hapat kryesorë të mëposhtëm:

- (1) Certis Belchim BV do të krijojë një sipërmarrje të përbashkët me Redestos duke blerë 30% të pjesëve në shoqërinë e varur në pronësi të plotë të Redestos, K. & N. Shoqëri Eftimiadis me një person (K. & N. Eftymiadis Single Member S.A.), një shoqëri aksionare private, e themeluar sipas ligjeve të Greqisë, zyra kryesore e së cilës është në Zonën Industriale të Selanikut, Kutia postare 48, 570 22 Sindos, Greqi, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Grek me numrin G.E.M.I. 058037204000 („KNE” ose „K+N Eftimiadis”).

Cestis Belchim BV do të rrisë pjesën e saj në KNE Certis BV. (KNE Certis BV) deri në 70% dhe do të bashkojë një pjesë të biznesit të saj me ndërmarrjen e përbashkët. KNE Certis B.V është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjit holandez, me seli të regjistruar në Shtadsplatau 16, posta 607, 3500 AP Utreht, Holandë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Holandez (*Handelsregister*) me numrin 856240941 („KNE Certis”). Aktualisht, KNE Certis është në pronësi të Redestos S.A, me një pjesë prej 69,88%, dhe Certis Belchim B.V, me një pjesë prej 30,12% (që i jep asaj të drejta kontrolli).

- (2) Pas zbatimit të Transaksionit të Propozuar, Certis Belchim synon t'ia dorëzojë kontratat me klientët në Maqedoninë e Veriut KNE Certis, e cila do të kryejë në mënyrë të pavarur operacionet e biznesit në Maqedoninë e Veriut me produkte për mbrojtjen e bimëve.

Si rezultat i Transaksionit të Propozuar, Certis Belchim dhe Redestos do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Ndërmarrjen e Përbashkët të sapothemeluar (e përbërë nga KNE dhe KNE Certis) në kuptim të nenit 12, paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS

KRYETARE

Ана Николоска